

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti krime të rënda - Divizioni penal, si gjykatë penale e shkallës së parë, në trup gjykues të përbërë prej Aziz Shaqirit – kryetar i trupit gjykues, Islam Thaçi dhe Ramiz Azizi, që të dy anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi, në lëndën penale të akuzuarit B.P. nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale mashtrim në votime nga neni 180 lidhur me nenin 23 të Kodit penal të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm KPK-s), të cilin sipas autorizimit e mbron av. E.P. nga ..., sipas aktakuzës PP. nr. 1800/2011 të datës 05. 09 të vitit 2011 të cilën e përfaqësoj prokurori i shtetit Mr. Sc. Isuf Sadiku, ndaj të cilit është veçuar procedura penale sipas aktvendimit procedural të datës 06 maj të vitit 2016, pas mbajtjes së seancës së fundit të shqyrtimit gjyqësor, verbal dhe publik më datën **21 mars të vitit 2017**, mori dhe në prani të prokurorit të shtetit, si dhe të të akuzuarit me mbrojtësin e tij sipas autorizimit, në të njëjtën ditë publikisht shpalli,

A K T G J Y K I M

I. I akuzuari B.P. nga babai Q. dhe nëna B. – me mbiemër të vajzërisë L., i lindur më datën ... në ..., tani me vendbanim në fshatin ..., Komuna e ..., me venqëndrim dhe punë të përkohshme në ..., shkollën e mesme të kryer, me gjendje të mesme ekonomike, i papunësuar, i pamartuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

Ë shtë f a j t o r

Sepse në zgjedhjet parlamentare të Republikës së Kosovës, të mbajtur më 12 dhjetor të vitit 2010, në Qendrën e votimit 2605D/01 në Shkollën Fillore “ ... “ në fshatin ..., i pandehuri B.P. me të tjerët dhe atë të akuzuarit N.P., R.Z., F.D. dhe B.M. si anëtarë të komisionit votues, kanë falsifikuar rezultatet e zgjedhjeve për deputetë në Parlamentin e Kosovës, në atë mënyrë që gjatë dhe pas numërimit të votave kanë manipuluar me 861 vota, ashtu që subjekteve politike dhe kandidatëve konkurrues për anëtarë të Parlamentit të Kosovës, iu kanë shtuar apo hequr votat e dhëna nga

votuesit dhe pas kësaj i kanë regjistruar në mënyrë jo të saktë në formularët e rezultateve të kandidatëve dhe në këtë mënyrë kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rezultatet e votimit edhe atë në favor të subjekteve dhe kandidatëve të tyre të preferuar, duke i dëmtuar subjektet e partive tjera politike dhe kandidatët e tyre,

- duke kryer në bashkëkryerje veprën penale **mashtrimi në votime** nga neni 180 lidhur me nenin 23 të KPK-s,

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të cituara, nenit 4, 7, 23, 41, 45, 49, 50, 51-54, 56, 73, 74 dhe 75 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPRK-s, nenit 247 lidhur me nenin 233 paragrafi 18-22 dhe nenin 326 paragrafi 4 lidhur me nenin 248 , por edhe nenin 365 të Kodit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtutjeshëm KPP) të akuzuarit në fjalë,

I SHQIPTON DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të njëjtit i cakton **dënimin me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muajve**, duke urdhëruar në të njëjtën kohë që dy dënime mos të ekzekutohet nëse i njëjti **gjatë periudhës verifikuese prej një (1) viti**, duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale, nën kërcënim të revokimit të këtij dënimi në kuptim të nenit 53 dhe 54 të KPRK-s.

II. Nëse i akuzuari në fjalë në kuptim të nenit 103 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 2.2 të KPRK-s nuk kryen vepër tjetër penale ose nuk vërtetohet me aktgjykim të plotfuqishëm se ka kryer më parë vepër penale, pas kalimit të periudhës prej një viti nga dita e skadimit të periudhës së verifikimit prej një viti, për të akuzuarin në fjalë do të bëhet rehabilitimi ligjor duke iu shlyer dënimi i shqiptuar me kusht nga evidenca e personave të dënuar, pa pasur nevojë që të nxirret aktvendim i veçantë.

III.DETYROHET i akuzuari në fjalë që të paguaj shpenzimet e procedurës penale edhe atë përkitazi me paushallin gjyqësor në shumën prej tridhjetë (30) Eurove, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Organi kompetent i ndjekjes penale ka ngritur aktakuzë kundër të akuzuarve në fjalë duke përfshirë edhe B.P., për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer si bashkëkryesor veprën penale lëndore.

Ndaj të akuzuarit B.P. me aktvendim procedural në seancën gjyqësore të datës 06 maj të vitit 2016 ka qenë e veçuar procedura penale, pasi që i njëjti ka qenë në Zvicër sipas të dhënave të dorëzuesit në fletë kthesë, kështu që ndaj tij së pari është lëshuar urdhër arresti e pastaj edhe urdhri për lëshimin e letër rreshtimit.

Pasi që i akuzuari përmes mbrojtësit të tij të autorizuar është paraqitur në gjykatë, kështu që pas arritjes së marrëveshjes për pranimin e fajësisë, është caktuar seanca e shqyrtimit gjyqësor duke u ftuar palët dhe mbrojtësi i autorizuar.

Gjykata pas vlerësimit të marrëveshjes lëndore mbi pranimin e fajësisë dhe provave në shkresa të lëndës ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit në fjalë duke pasur parasysh faktet e vërtetuara nga provat e pakontestueshme, qëndrojnë të gjitha tiparet e veprës penale lëndore, për të cilën edhe e ka shpallur fajtor dhe dënuar me kusht sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata pasi që është bindur se marrëveshja lëndore është arritur në kuptim të nenit 233 paragrafi 18-22 dhe nenit 247 të KPP-s dhe se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 326 paragrafi 1 dhe 4 të KPP-s duke përfshirë edhe rrethanat e pranueshme në kuptim të nenit 75 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPRK-s përkitazi me marrëveshjen e arritur mes palëve mbi pranimin e fajësisë, me të drejtë ka gjetur se edhe me dënimin sipas marrëveshjes lëndore mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimit me burgim me kusht në kuptim të nenit 50 lidhur me nenin 41 të KPRK-s, duke parandaluar të akuzuarin në fjalë dhe qytetarët potencial që në ardhmen mos të kryejnë vepra penale të kësaj natyre por edhe të natyrave tjera.

Pas shpalljes së aktgjykimit në kuptim të nenit 368 të KPP-s gjykata e ka njoftuar të akuzuarin e pranishëm lidhur me rëndësinë e dënimit me kusht por edhe me kushtet të cilat duhet plotësuar, në mënyrë që dënimi lëndor me kusht mos të revokohet, e pasi që janë udhëzuar palët lidhur me të drejtën në ankesë, të njëjtat shprehimisht kanë deklaruar se heqin dorë nga e drejta në ankesë. Andaj, kryetari i trupit gjykues në kuptim të nenit 485 paragrafi 2 të KPP-s konstaton se aktgjykimi lëndor është bërë i plotfuqishëm më datën 21 mars të vitit 2017.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor vendosi në kuptim të nenit 450 lidhur me nenin 453 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë, në kuptim të nenit 233, 326 paragrafi 4 dhe nenit 365 të KPP është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti për krime të rënda

Divizioni Penal PKR.nr. 176/2016, më dt.21 mars të vitit 2017

**Sekretarja juridike,
Kadrije Zymberi**

**Kryetari i trupit gjykues,
Aziz Shaqiri, d.v.**

Udhëzim për mjetin juridik: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimet të ekzemplarit të këtij aktgjykimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj Gjykate.

VËREJTJE: Pasi që palët kanë heqë dorë nga e drejta në ankesë shprehimisht në procesverbal, aktgjykimi lëndor bëhet i plotfuqishëm më datën **21 mars të vitit 2017.**